VENDIM
Nr.15, datë 22.7.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar	i Gjykatës Kushtetuese,		
Gjergji Sauli	Anëtar	i	“	“
Fehmi Abdiu	Anëtar	i	“	“
Kujtim Puto	Anëtar	i	“	“
Xhezair Zaganjori	Anëtar	i	“	“
Vitore Tusha	Anëtare	e	“	“
Petrit Plloçi	Anëtar	i	“	“
Sokol Sadushi	Anëtar	i	“	“
Sokol Berberi	Anëtar	i	“	“

me sekretare Brunilda Bara, në datën 17.4.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.8 Akti, që i përket:

KËRKUES: HYSNI TAFILI, përfaqësuar nga avokat Viktor Konomi, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR:

PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga Skënder Breca, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.536, datë 22.6.2007 të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f e 134 të Kushtetutës, si dhe neni 6 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi, përfaqësuesin e kërkuesit, që u shpreh për pranimin e kërkesës, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, që kërkoi pranimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.13, datë 24.1.2005, ka deklaruar fajtor kërkuesin Hysni Tafili për veprat penale të kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror dhe të dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit dhe e ka dënuar me 8 vjet burgim për veprën penale të parashikuar nga neni 297/2 i Kodit Penal (KP) dhe 17 vjet burgim për veprën penale të parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal. Në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, kërkuesi është dënuar me 20 vjet burgim.

Kërkuesi ka kundërshtuar vendimin e mësipërm në gjykatën e apelit. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.135, datë 19.4.2007, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit.

Kundër vendimit të gjykatës së apelit, kërkuesi ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.536, datë 22.6.2007, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit përsa i përket deklarimit fajtor të kërkuesit sipas nenit 298/3 të Kodit Penal dhe prishjen e këtij vendimi e pushimin e gjykimit të çështjes për veprën penale të parashikuar nga neni 297/2 të Kodit Penal, për shkak se fakti nuk përbën vepër penale. Kolegji Penal ka vendosur edhe ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit, përsa i përket masës së dënimit, duke e dënuar kërkuesin me 20 vjet burgim.

Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i sipërpërmendur i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor në drejtimet e mëposhtme:

- Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e mosrëndimit të pozitës së të pandehurit. Ky Kolegj, edhe pse ka vendosur pushimin e gjykimit për veprën penale të parashikuar nga neni 297/2 i Kodit Penal, e ka dënuar kërkuesin me 20 vjet burgim, duke dhënë një dënim më të lartë se gjykata e rrethit.

- Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e paanshmërisë dhe të barazisë para ligjit, pasi ka diferencuar kërkuesin nga të pandehurit e tjerë. Kjo Gjykatë, ndërsa ka ulur masën e dënimit për të pandehurit e tjerë, për kërkuesin e ka rritur nga 17 në 20 vjet burgim. Pjesa arsyetuese e vendimit nuk korrespondon me masën e dënimit dhënë për kërkuesin.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, kërkoi pranimin e kërkesës, duke parashtruar:

- Çështja në Gjykatën e Lartë është shqyrtuar mbi bazën e rekursit të kërkuesit dhe jo me rekurs të prokurorit. Neni 425/3 i Kodit të Procedurës Penale (KPP) parashikon se kur apelues është i pandehuri, gjykata nuk mund t'i caktojë atij një dënim më të rëndë nga ai që i ka caktuar gjykata me vendimin ndaj të cilit është paraqitur rekursi.

- Në pjesën arsyetuese të vendimit, Gjykata e Lartë shprehet se ndryshimi lidhur me nenin 272/2 të Kodit Penal duhet të sjellë diferencim në masat e dënimit dhe zbutje të tyre, ndërsa në dispozitiv, teksa për të gjithë të gjykuarit e tjerë ka zbutur masat e dënimit, për kërkuesin i ka rritur nga 17 në 20 vjet burgim.

II

Gjykata Kushtetuese (Gjykata) i vlerëson pretendimet e kërkuesit në drejtim të standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe në kontekstin e çështjes në shqyrtim, se çfarë detyrimesh i ngarkon Gjykatës së Lartë respektimi i parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit dhe parimit të paanshmërisë dhe barazisë para ligjit.

1. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të mosrëndimit të pozitës së të pandehurit në gjykimin në Gjykatën e Lartë

Kërkuesi pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor nëpërmjet rëndimit të pozitës së të tij në Gjykatën e Lartë. Përfaqësuesi i Prokurorisë së Përgjithshme parashtroi gjithashtu se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e ka zbatuar ligjin penal në mënyrë të gabuar, duke dhënë një dënim më të lartë për kërkuesin e duke rënduar kështu pozitën e tij, në një kohë që rekursi para Gjykatës së Lartë ishte paraqitur nga kërkuesi.

Parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit (*reformatio in peius*) parashikohet në legjislacionin procedural penal dhe konkretisht në nenin 425 pika 3 të Kodit të Procedurës Penale Sipas këtij neni, "kur apelues është vetëm i pandehuri, gjykata nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë, të zbatojë një masë sigurimi më të rëndë, t'i japë pafajësisë një shkak më pak të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar". Në një dispozitë tjetër (neni 244/3) të Kodit të Procedurës Penale gjykata ndalohet që të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori.

Gjykata është shprehur se parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit është i lidhur me garancinë e akcesit në gjykatë si element i procesit të rregullt. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta) dhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) nuk e përmendin në mënyrë të shprehur këtë parim, por ai në vetvete e përmban dimensionin kushtetues. Zbatimi i këtij parimi është një garanci më shumë për të gjykuarin, me qëllim që ai të realizojë në mënyrë efektive të drejtën për t'iu drejtuar me ankim gjykatës. Gjykata është shprehur se ekzistenca e këtij parimi u jep mundësi të gjykuarve që të mos heqin dorë nga garancitë që ofron Kushtetuta vetëm nga frika se mund të dëmtohen rëndë interesat e tyre (shih vendimin nr.13/2003 të Gjykatës Kushtetuese).

Nga ky këndvështrim, mosrespektimi i parimit për mosrëndimin e pozitës së të pandehurit do të përbënte njëkohësisht cenim të thelbit të një gjykimi dhe në veçanti të së drejtës

për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të KEDNJ.

Gjykata e Lartë, sipas Kodit të Procedurës Penale, *shqyrton çështjen brenda kufijve të shkaqeve të ngritura. Por, për çështjet ligjore që duhet të shihen kryesisht nga gjykata në çdo gjendje e shkallë të procesit, të cilat nuk janë parë, Gjykata e Lartë ka të drejtë të vendosë*. Parimi i mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, i ngritur në standard kushtetues, duhet të respektohet në të gjitha shkallët e gjykimit, duke përfshirë dhe atë në Gjykatën e Lartë.

Në rastin në shqyrtim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka deklaruar fajtor kërkuesin për veprat penale të kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror dhe të dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit, dhe e ka dënuar me 8 vjet burgim për veprën penale të parashikuar nga neni 297/2 i Kodit Penal (KP) dhe 17 vjet burgim për veprën penale të parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal. Në bashkim të dënimeve, në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, kërkuesi dënohet me 20 vjet burgim. Gjykata e Apelit Vlorë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit.

Bazuar në dokumentet e dosjes gjyqësore rezulton se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është vënë në lëvizje vetëm me rekursin e kërkuesit. Ky Kolegj, në përfundim të gjykimit, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit përsa i përket deklarimit fajtor të kërkuesit sipas nenit 298/3 të Kodit Penal dhe prishjen e këtij vendimi dhe pushimin e gjykimit të çështjes për veprën penale të parashikuar nga neni 297/2 të Kodit Penal, për shkak se fakti nuk përbën vepër penale. Përsa i përket masës së dënimit të kërkuesit, Kolegji ka vendosur dënimin me 20 vjet burgim për veprën penale të parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal, ndërkohë që kërkuesi ishte dënuar për këtë vepër me 17 vjet burgim.

Siç rezulton nga faktet e mësipërme, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin vetëm të kërkuesit, ka caktuar, për veprën penale të parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal, një masë dënimi më të rëndë nga ai i vendimit të apeluar. Në këto kushte, Gjykata e Lartë nuk ka respektuar parimin për mosrëndimin e pozitës së të pandehurit, duke i cenuar kërkuesit të drejtën për t'iu drejtuar me ankim gjykatës si aspekt i procesit të rregullt ligjor në gjykimin në fjalë.

Sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se vendimi nr.536, datë 22.6.2007 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, përsa i përket caktimit të masës së dënimit të kërkuesit, është marrë në kundërshtim me kërkesat e një procesi të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe KEDNJ-së.

2. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të paanshmërisë dhe barazisë para ligjit në gjykimin në Gjykatën e Lartë

Kërkuesi pretendon se Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e paanshmërisë dhe të barazisë para ligjit, sepse e ka diferencuar atë nga të pandehurit e tjerë; kjo Gjykatë, ndërsa ka ulur masën e dënimit për të pandehurit e tjerë, për kërkuesin e ka rritur nga 17 në 20 vjet burgim; pjesa arsyetuese e vendimit nuk korrespondon me masën e dënimit dhënë për kërkuesin.

Lidhur me parimin e paanshmërisë si aspekt i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, Gjykata është shprehur se ekzistojnë dy teste për të vlerësuar nëse një gjykatë është e paanshme: i pari konsiston në përcaktimin e bindjes personale të gjyqtarit në fjalë, në një çështje të dhënë; dhe i dyti, në vlerësimin nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të ligjshëm në këtë drejtim. Përjashtimi i këtyre dyshimeve është garanci për besimin që duhet të frymëzojnë gjykatat në një shoqëri demokratike për publikun dhe, mbi të gjitha, për palët në procesin gjyqësor (vendimi nr.18/2007 i Gjykatës Kushtetuese).

Kërkuesi nuk ka parashtruar argumente për të mbështetur pretendimin e tij për cenimin e parimit të paanshmërisë dhe të barazisë para ligjit, sipas elementeve të përmendura më sipër. Për këtë arsye Gjykata çmon se ky pretendim është i pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.536, datë 22.6.2007 të Gjykatës së Lartë, përsa i përket të gjykuarit Hysni Tafili.

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Vladimir Kristo (kryetar).

Anëtarë: Fehmi Abdiu, Gjergj Sauli, Xhezair Zaganjori, Kujtim Puto, Vitore Tusha, Petrit Plloçi, Sokol Berberi, Sokol Sadushi.